



**DOKUMENT POLITIKASH**

**SFIDAT E GAZETARËVE DHE  
LIRIA E MEDIAS NË SHQIPËRI:**

**VËSHTRIM KRAHASUES ME  
RAJONIN E BALLKANIT PERENDIMOR DHE  
BASHKIMIN EUROPIAN**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**Përgatiti:** Znj. Ola Mitre, eksperte e jashtme KShH

Znj. Enegrida Bënja, juriste/asistente projektesh, KShH

**Rishikoi:** Znj. Erida Skëndaj, drejtore ekzekutive, KShH

Znj. Rovena Vuksani, juriste/koordinatore projektesh, KShH

Ky raport u hartua në kuadër të projektit “Forcimi i Standardeve të Integritetit të Medias në Shqipëri” mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar nga East West Management Institute. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e East-West Management Institute dhe/ose Ambasadës Britanike në Tiranë

**Autor:** © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Adresa:

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al); [www@ahc.org.al](http://www@ahc.org.al)

## Përmbajtja e Dokumentit të politikave

### TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. Përmbledhje Ekzekutive .....</b>	<b>3</b>
<b>2. Metodologjia .....</b>	<b>4</b>
<b>3. Problematikat e gazetarëve në vendin e punës .....</b>	<b>5</b>
3.1 Informaliteti në punë .....	5
3.2 Pushimet javore dhe vjetore .....	7
3.3 Aksesi në gjykatë .....	9
3.4 Përfaqësimi sindikal .....	10
<b>4. Krahasimi me situatën në rajon .....</b>	<b>11</b>
4.1 Liria e medias dhe të drejtat e gazetarëve në Serbi .....	11
4.2 Kushtet dhe të drejtat e punonjësve të medias në Maqedoninë e Veriut .....	12
4.3 Situata e lirisë së shprehjes dhe të drejtave të gazetarëve në Kosovë .....	13
<b>5. Liria e medias dhe të drejtat e gazetarëve në Bashkimin Evropian .....</b>	<b>14</b>
5.1 Liria e medias në Bashkimin Evropian .....	14
5.2 Liria e shprehjes dhe të drejtat e gazetarëve në BE në vështrim krahasimor me situatën në vendin tonë ..	16
<b>6. Raste suksesi – rifitimi i të drejtës së gazetarëve .....</b>	<b>19</b>
<b>7. Konkluzione dhe rekomandime .....</b>	<b>21</b>
7.1 Rekomandime për institucionet publike .....	22
7.2 Rekomandime për organizatat e shoqërisë civile .....	23
7.3 Rekomandime për gazetarët .....	23

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Problematikat dhe shkeljet e të drejtave të gazetarëve, sidomos të drejtave të tyre të punës, kanë qenë në fokus të shumë studimeve dhe janë evidentuar nëpërmjet raporteve të ndryshme nga një sërë organizatash. Një prej tyre, është edhe “Raporti Studimor mbi të Drejtat e Punës së Gazetarëve” i vitit 2020 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit<sup>1</sup>, si dhe dy Barometra Kombëtar, të realizuar në sajë të një anketimi të realizuar nga KShH për vitet 2020 dhe 2021, me kontributin e ekspertëve në fushën e gazetarisë, të cilët kanë anketuar kolegët e tyre punonjës në sektorin e medias. Në këto publikime analizohen në detaje problematikat kryesore me të cilat ndeshen gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri.

Veç kërkimeve studimore, në kuadër të projektit “Forcimi i standarteve të integritetit në Shqipëri”, KShH ka realizuar dhe një sërë sesionesh me gazetarët dhe punonjësit e medias në qytete të ndryshme në të gjithë Shqipërinë. Gjatë këtyre takimeve, gazetarët kanë evidentuar problematikat kryesore që i shoqërojnë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, duke u fokusuar kryesisht në shkelje të të drejtave të tyre të punës, probleme në lidhje me publikimin e punëve të tyre si dhe mungesën e sigurisë gjatë kryerjes së detyrës së tyre.

Ky dokument politikash (Policy Paper) ka për synim të sjellë në vëmendje çështje që cenojnë lirinë e medias në vendin tonë, dhe që krijojnë një klimë ku shkelen të drejtat themelore të gazetarëve, duke ofruar një vështrim krahasimor me situatën në rajon si dhe situatën e përgjithshme në Bashkimin Evropian, për sa i përket aspekteve të respektimit të të drejtave të gazetarëve. Siç evidentohet më në detaje në seksionet më poshtë, vihet re se ende në vendin tonë shqetësimet kryesore lidhen me respektimin të drejtave themelore të punës, ku problematike evidentohet informaliteti në punë.

Krahasuar me vendet e rajonit, ku gazetarët dhe punonjësit e medias janë të organizuar në përfaqësi sindikale të cilat luftojnë për të drejtat e tyre, në vendin tonë mbetet problematike mungesa e organizimit të gazetarëve në një sindikatë të tillë, duke mundësuar kështu vetëm disa shoqata apo organizata të shoqërisë civile me fokus të drejtat dhe liritë e gazetarëve, të cilët nuk mund të kenë të njëjtin efektivitet në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të medias si një organizim në një sindikatë të formalizuar.

---

<sup>1</sup><https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/07/Research-Study-on-Journalists%E2%80%99-Labor-Rights.pdf>

Arsyet e mos krijimit të sindikatës janë të njëjta me ato që kanë të bëjnë me mungesën e reagimit nga vetë gazetarët kur të drejtat e tyre në punë shkelen. Frika nga hakmarrja e punëdhënësit dhe papunësia si rrjedhojë për shkak të solidaritetit pengon gazetarët në krijimin e këtij organizmi, por gjithashtu ka edhe një mungesë besimi tek kryesia e sindikatës, nisur nga modelet e dobëta të lëvizjeve dhe organizimeve sindikale në sektorë të tjerë të punësimit në vend.

KShH vëren se gazetarët janë pozicionuar dhe luftojnë në frontin e parë për të drejtat dhe liritë e njerëzve dhe në mbrojtje të interesit publik, realizojnë investime të rëndësishme, bëjnë kërkesa dhe kritika të drejta ndaj qeverisë, ankohen pse nuk u jepet informacion, por hezitojnë të mbrojnë të drejtat e tyre të ligjshme. Në kuptim të së drejtës së organizimit dhe standardeve për një media të lirë duhet të reagojë ndaj çdo lloj padrejtësie e shkeljeje kjo është një situatë tepër kritike e shqetësuese.

## 2. METODOLOGJIA

Ky dokument politikash u hartua me qëllim evidentimin e problematikave kryesore me të cilat ndeshen gazetarët në vendin tonë, sidomos për sa i përket të drejtave të tyre në punë, censurës me të cilën ata ndeshen për publikimin e lajmeve të caktuara, mungesës së sindikatave për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias etj. Së fundmi, ky punim ka si qëllim të ofrojë disa rekomandime të cilat do të mund të ndikonin në përmirësimin e situatës aktuale të gazetarëve në vendin tonë.

Grumbullimi i të dhënave dhe analizimi i tyre u realizua nëpërmjet përdorimit të disa instrumenteve sasiorë dhe cilësorë, si më poshtë vijon:

*Së pari*, për hartimin e këtij dokumenti, një burim i rëndësishëm informacioni kanë qenë diskutimet gjatë sesioneve informuese që KShH ka organizuar me gazetarët dhe punonjësit e medias në qytete të ndryshme të Shqipërisë (Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Vlorë). Çështjet e ngritura nga punonjësit kanë kontribuar në vlerësimin e lirisë së medias në vendin tonë si dhe identifikimin e shkaqeve dhe problematikave kryesore me të cilat hasen gazetarët dhe punonjësit e medias gjatë ushtrimit të detyrës tyre për informimin e qytetarëve.

*Së dyti*, KShH, me qëllim ofrimin e një vështrimi krahasimor të situatës së lirisë së medias dhe të drejtave të gazetarëve në vendin tonë me rajonin, realizoi një kërkim analizues të raporteve të ndryshme të hartuara nga organizata dhe institucione të ndryshme, të fokusuara kryesisht në problematikën e ngjashme dhe të veçanta me të cilët hasen punonjësit e medias dhe gazetarët në këto vende. Një fokus i veçantë ju kushtua edhe krahasimit të situatës me vendet e Bashkimit

Evropian ku baza kryesore e hartimit të kësaj analize ishin Raportet e Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit në BE si dhe Raportet progresit vjetor për Shqipërinë.

### 3. PROBLEMATIKAT E GAZETARËVE NË VENDIN E PUNËS

Legjislacioni shqiptar, me anë të Kodit të Punës si dhe ligjeve apo akteve të tjera rregullatore, garanton të drejtat në punë për çdo punëmarrës në vendin tonë. Prej miratimit fillestar në vitin 1995, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë është përditësuar katër herë, me ndryshimet e fundit të realizuara në vitin 2015, të cilat përfshinë përmirësime në disa parashikime në drejtim të marrëdhënieve kontraktuale midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, pushimeve vjetore, pushimit të paguar, etj.<sup>2</sup> Pavarësisht ekzistencës së legjislacionit mbrojtës, të dhënat tregojnë se shpeshherë gazetarët në Shqipëri përballen me shkeljen e një sërë të drejtash në vendin e punës. Gjatë periudhës prill – qershor 2021, Komiteti Shqiptar i Helsinkit realizoi një seri workshop-esh me gazetarë që ushtrojnë profesionin në Qarkun e Tiranës, Elbasanit, Korçës, Shkodrës dhe Vlorës<sup>3</sup>, më qëllim identifikimin e problematikave dhe shkaqeve kryesore të mungesës së respektimit të të drejtave në vendin e punës. Gjithashtu, gazetarët dhe punonjësit e medias evidentojnë se pavarësisht shkeljeve të të drejtave ata hezitojnë edhe të vënë në lëvizje mekanizmat apo institucionet e posaçme si gjykata për fitimin e të drejtave të tyre në vendin e punës. Shkaqet e mos ezaurimit të këtyre mjeteve ligjore të ankimit lidhen me mungesën e besimit tek inspektorati i punës, pamundësinë financiare për të paguar shpenzimet gjyqësore dhe kostot e avokatit, sjelljet hakmarrëse të pronarëve të medias që solidarizohen kur ka ankesa të tilla dhe nuk i marrin në punë punonjësit që ankohen, kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, etj. Problematikat kryesore të cilat janë evidentuar nga gazetarët dhe punonjësit e medias në vendin tonë janë si më poshtë vijon:

#### 3.1 INFORMALITETI NË PUNË

Informaliteti përbën një nga problemet kryesore që hasin gazetarët dhe punonjësit e medias në punë. Gjatë takimeve të realizuara, ata referuan ekzistencën e 2 formave të informalitetit:

---

<sup>2</sup> Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar

<sup>3</sup> [1] <https://www.facebook.com/329757960481074/posts/3575530225903815/> ;  
<https://www.facebook.com/329757960481074/posts/3599875030136001/> ;  
<https://www.facebook.com/329757960481074/posts/3695889197201250/> ;  
<https://www.facebook.com/329757960481074/posts/3709938112463025/> ;  
<https://www.facebook.com/329757960481074/posts/3719011358222367/> ;  
<https://www.facebook.com/329757960481074/posts/3755932144530288/>

1. **Informalitet i plotë:** lidhet me mungesën e marrëdhënies kontraktuale të gazetarëve me punëdhënësin e tyre. Kryesisht, informaliteti i plotë referohet nga gazetarët që ushtrojnë profesionin në rrethet jashtë Tiranës, të cilët nuk disponojnë asnjë kontratë që rregullon marrëdhënien e punës me punëdhënësin. Kjo përbën një shkelje flagrante të Kodit të Punës, ku në nentit 21 të tij parashikohet se, *“kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë”*<sup>4</sup>.
2. **Informaliteti i pjesshëm,** i cili evidentohet nga gazetarët dhe punonjësit e medias, në thelb ka një marrëdhënie pune të rregulluar nëpërmjet një kontrate megjithatë parashikimet kontraktuale nuk janë në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kështu, informaliteti i pjesshëm lidhet me deklaratimet joreale të pagave të gazetarëve pranë organeve tatimore, duke bërë që një pjesë e pagës të merret “në dorë” dhe jo në bankë, një fenomen që u pohua gjerësisht gjatë takimeve. Këto shqetësime konfirmohen edhe në Barometrin Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri 2020<sup>5</sup>, ku theksohet se mbi 31% e punonjësve të medias nuk e marrin të plotë pagën në bankë, çka përbën një shkelje të nenit 118 të Kodit të Punës. Sipas të njëjtit Barometër për vitin 2021 të realizuar nga KShH<sup>6</sup>, 84% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, duke dëshmuar një përmirësim në masën 15%, në raport me të dhënat e Barometrit të vitit 2020. Megjithatë, vlen të theksohet se numri i atyre që punojnë pa kontratë mbetet sërish i lartë, pasi rreth 16% u përgjigjën se nuk kanë një kontratë të rregullt pune apo nuk kanë informacion për marrëdhënien e tyre kontraktuale, edhe pse një nivel i përmirësuar në masën 14%, në raport me të dhënat e një viti më parë (2020).

Disa prej gazetarëve që kanë marrë pjesë në takimet informuese të organizuara nga KShH deklarojnë se edhe nëse janë të siguar, në disa raste deklaratimet e pagave të tyre nuk pasqyrojnë realisht shumën për të cilën ata paguhën. Në rastin e një gazetaresje e cila kishte marrë lejen e lindjes, për shkak se punëdhënësi i saj kishte deklaruar një pagë minimale, rroga që ajo merrte gjatë periudhës së lejes së lindjes ishte shumë e ulët në krahasim me pagën reale që ajo merrte në kushte informale.

Informaliteti në punë, si i plotë ashtu edhe i pjesshëm, shkakton pasoja negative në drejtim të përfitimeve afatshkurtër dhe afatgjata për gazetarët dhe punonjësit e medias. Ndër efektet afatshkurtra mund të përmendet është reduktimi i të ardhurave për paaftësi nga sëmundjet, të ardhurat për barrëlindje, kompensimi për orët shtesë të kryera gjatë festave zyrtare apo shtesa mbi pagë për orët e punës së kryer gjatë natës<sup>7</sup>. Ndërkohë që, në aspektin afatgjatë, mungesa e

<sup>4</sup> Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar

<sup>5</sup> Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri 2020, Tetor 2021

<sup>6</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi\\_Tetor-2022-KShH.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf)

<sup>7</sup> Neni 26; 27; 28; 29, 91 i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar

deklarimit të pagës reale pranë organeve tatimore ndikon drejtpërdrejt dhe negativisht në masën e pensionit të pleqërisë<sup>8</sup>. Nga ana tjetër, mungesa e një kontrate me të drejta dhe detyrime për të dyja palët ndikon në mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve gazetarë. Kështu, në rast të largimit të padrejtë nga puna apo shkeljeve të tjera të të drejtave gjatë ushtrimit të detyrës, ndjekja e çështjes në gjykatë mund të rezultojë më e vështirë, çka ndikon edhe në hezitimin e gazetarëve për të rivendosur në vend të drejtën e tyre nëpërmjet gjykatës. Pavarësisht se mungesa e kontratës së punës nuk e pengon gjykatën që të prezumojë ekzistencën e marrëdhënies së punës, në kuptimin e Nenit 12 të Kodit të Punës, disa studime kanë evidentuar se mungesa e një kontrate pune, e bën realisht të vështirë të provohet marrëdhënia e punës në një proces gjyqësor<sup>9</sup>. Ndërkohë që informaliteti do të ndikonte edhe magnitudën e rritimit të së drejtës pasi në kushtet e një kontrate që nuk reflekton pagën reale, edhe përfitimet financiare në rast të një procesi gjyqësor të suksesshëm ndaj punëdhënësit do ishin më të pakta.

### 3.2 PUSHIMET JAVORE DHE VJETORE

Mungesa e pushimeve javore dhe atyre vjetore është një nga shkeljet e tjera të evidentuara nga gazetarët dhe punonjësit e medias në drejtim të marrëdhënieve të punës. Arsyet se përse punonjësit e medias si punëmarrës, nuk kërkojnë lejen vjetore dhe pushimet javore nga punëdhënësit lidhet me frikën e hakmarrjes prej këtij të fundit, pasi si rezultat mund të humbasin vendin e punës.

Kjo problematikë u referua thujse unanimisht nga të gjithë gazetarët e pranishëm në takimet e zhvilluar në 5 qarqet e vendit. Vetëm në një rast në Tiranë, një prej gazetarëve pohoi se “*së fundmi punëdhënësi i saj ka lejuar pushimet e plota vjetore*”. Pavarësisht se parashikimet në nenin 92, të Kodit të Punës garantojnë se “*kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim*”, gazetarët dhe punonjësit e medias referuan se iu lejohet të marrin pushime vetëm 2 javë kalendarike në vit apo 50% më pak nga çfarë parashikon legjislacioni. Vlen të theksohet se parashikimi ligjor mbi pushimet vjetore vendos një standard minimum për kohëzgjatjen e pushimeve për punëmarrësin gjatë një viti, dhe si i tillë duhet duhet respektuar nga punëdhënësi. Gjithashtu, gazetarët dhe punonjësit e medias pohojnë se punojnë minimalisht 6 ditë në javë me orar të plotë. Kjo praktikë rezulton gjithashtu në kundërshtim me Kodin e Punës, i cili përcakton se “*kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë*<sup>10</sup> në javë”. Kjo problematike rezulton e mbartur në kohë pasi konfirmohet edhe nga një sërë

---

<sup>8</sup> Ligji Nr. 11.05.1993, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,

i ndryshuar

<sup>9</sup> Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Studimor mbi të Drejtat e Punës së Gazetarëve, Maj 2020, Faqe 86

<sup>10</sup> Neni 83, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar



studimesh të realizuar gjatë viteve të fundit nga organizata të ndryshme në vend.<sup>11</sup> Kështu, sipas Barometrit Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri 2020, 59% e punonjësve të medias deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, ndërkohë që 18% e të anketuarve deklarojnë se nuk bëjnë asnjë ditë pushim. Sipas të njëjtit Barometër të realizuar nga KShH për vitin 2021<sup>12</sup>, 63.5% e punonjësve të medias deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, një përqindje më e lartë se ajo e vitit të kaluar, përkatësisht me 59%. I lartë mbetet edhe numri i atyre që nuk bëjnë pushim javor (14.5%). Vetëm 34% e punonjësve gëzojnë efektivisht të drejtat për pushime vjetore. Kjo e dhënë tregon një përmirësim në krahasim me gjetjet e vitit të shkuar kur kjo shifër ishte vetëm 16.5%.

### *3.2.1 Stresi dhe situatat traumatike*

Pavarësisht trendit të lehtë përmirësues, informaliteti dhe mungesa e lejes dhe pushimeve te plota sipas Kodit të Punës, përveçse është në shkelle të legjislacionit në fuqi duke mos respektuar të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve të medias, ndikon negativisht edhe në shëndetin fizik e mendor të gazetarëve. Në studimin “Stresi në vendin e punës”, thuhet se ekziston një lidhje statistikisht domethënëse midis punës së zgjatur përtej orarit dhe problemeve shëndetësore. Këto probleme përfshijnë ndër të tjera sëmundje si: diabeti, sindroma metabolike, sëmundje të qarkullimit të gjakut, ankth dhe çrregullime të tjera psikologjike, rënie të funksioneve kognitive dhe probleme të gjumit<sup>13</sup>.

Ndërkohë, së fundmi ka një tendencë ndërkombëtare për të shkurtuar javën e punës në 4 ditë, bazuar në studime që tregojnë se të punosh më pak rrit produktivitetin, ndërsa përfitimi është i dyanshëm: si për punëdhënësin, ashtu edhe për punëmarrësin<sup>14</sup>. Ndonëse në rastin e gazetarëve dhe punonjësve të medias në Shqipëri fokusi duhet të jetë respektimi i orarit maksimal të punës i reduktuar nga 6 ditë që evidentohet aktualisht në 5 ditë, këto argumente vlejnë për të kuptuar rëndësinë që ka pushimi javor në produktivitetin si dhe mirëqenien e gazetarëve.

Vlen të theksohet gjithashtu se sipas Barometrit Kombëtar për Lirinë e Medias në Shqipëri, punonjësit e medias vijuan të raportonin nivele të larta stresi për shkak të punës. Rreth 68.5% e të

---

<sup>11</sup> Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, Tregu i punës në media .

Tiranë: IDRA, 2019; Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Studimor mbi të Drejtat e Punës së Gazetarëve, Maj 2020; Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri 2020, Tetor 2021

<sup>12</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi\\_Tetor-2022-KShH.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf)

<sup>13</sup> Fondacioni Friedrich Ebert, Stresi në Vendin e Punës, Dhjetor 2019

<sup>14</sup> <https://360grade.al/432237/studimi-4-arsye-pse-java-e-punes-duhet-te-kete-4-dite/>

anketuarve ose 11% më pak se një vit më parë, raportuan se kishin mbuluar dhe raportuar ngjarje që u kishin shkaktuar tronditje të fortë psikologjike. Megjithatë kërkimi i ndihmës mjekësore për këto situata mbetet thujse tabu dhe vetëm 6% e punonjësve të pyetur pohuan se kishin kërkuar ndihmë mjekësore apo psikologjike.

### 3.3 AKSESI NË GJYKATË

Pavarësisht se përballen dhe referojnë një sërë shkeljesh të të drejtave të tyre në punë si dhe gjatë ushtrimit të detyrës, gazetarët dhe punonjësit e media shprehen se hezitojnë ti drejtohen gjykatave. Gjatë takimeve të organizuara, ata pohuan se edhe në rastin më ekstrem të largimit nga puna, ndjekja e të drejtës së tyre në rrugë gjyqësore, nuk është një alternativë e preferuar prej tyre. Kjo zgjedhje është e motivuar prej një sërë arsyesh, ku kryesisht dominojnë vonesat në proceset gjyqësore, por sidomos ndikimi që mund të sillte në punësimet e ardhshme një proces gjyqësor me punëdhënësin paraardhës. Një tjetër arsye lidhet edhe me aspektin financiar dhe pamundësinë për të përballuar kostot e procesit gjyqësor, duke marrë parasysh nivelin e pagave, sidomos të gazetarëve dhe punonjësve të medias të terrenit. Pamundësia financiare si dhe ndikimi të punëdhënësit e tjerë në fushën e medias është problematike më evidente tek gazetarët dhe punonjësit e medias që ushtrojnë profesionin e tyre në rrethet jashtë Tiranës. Kështu ata theksojnë se mundësitë e gazetarëve të rretheve për t'u punësuar, pas një largimi të mundshëm edhe pse të padrejtë, janë më të pakta, pasi edhe numri i mediave që kanë korrespondentë në rrethe është më i ulët. Kjo i kufizon edhe më tepër gazetarët dhe punonjësit e medias, të cilët në raste konfliktesh me punëdhënësin e tyre, t'i drejtohen gjykatave për të marrë një zgjidhje dhe për të rivendosur të drejtën e tyre në vend. Aksesit i ulët në gjykatë konfirmohet edhe në nga një sërë studimesh. Sipas Barometrit të Lirisë së Medias në Shqipëri 2021 të KShH, numri i çështjeve gjyqësore me palë gazetar apo punonjës të medias është tejet i kufizuar. Punonjësit e medias reflektojnë arsye të ngjashme si të një vitit më parë (2020), sa i takon pengesave për t'iu drejtuar gjykatës për të patur një mjedis që j'u garanton lirinë e shprehjes. Burokracia në përballjen me gjykatën është faktori kryesor sipas të anketuarve (63.5% të rasteve), ndjekur nga frika nga hakmarrja e punëdhënësit (55.5%). Me ndryshime të papërfillshme, këto të dhëna mbeten thujse të njëjta me gjetjet në Barometrin e vitit 2020<sup>15</sup>.

Mungesa e besimit për t'ju drejtuar organeve gjyqësore vihet re edhe gjatë veprimtarisë së KShH-së, i cili ka ofruar ndihmë juridike dhe përfaqësim gjyqësor falas për gazetarët dhe punonjësit e medias. Pavarësisht se gazetarët janë të interesuar të njohin të drejtat e tyre në rast të ndonjë shkeljeje nga punëdhënësi, ata hezitojnë ta ndjekin çështjen në rrugë gjyqësore ose për arsye të ndryshme tërhiqen nga procesi në faza të ndryshme para fillimit të procesit gjyqësor.

---

<sup>15</sup> <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi-Tetor-2022-KShH.pdf>

Në përfundim, KShH vëren se gazetarët luftojnë në frontin e parë për të drejtat e të tjerëve dhe në mbrojtje të interesit publik, realizojnë investigime të rëndësishme, bëjnë kërkesa dhe kritika të drejta ndaj qeverisë, ankohen pse nuk u jepet informacion, por hezitojnë të mbrojnë të drejtat e tyre të ligjshme. Në kuptim të së drejtës së organizimit dhe standarteve për një media të lirë duhet të reagojë ndaj çdo lloj padrejtësie e shkeljeje kjo është një situatë tepër kritike e shqetësuese.

### 3.4 PËRFAQËSIMI SINDIKAL

Pavarësisht ekzistencës së problematikave të ndryshme në industrinë e medias për një kohë të gjatë, në Shqipëri nuk ekziston asnjë sindikatë që të përfaqësojë interesat e punonjësve të medias. Arsyet e mos krijimit të sindikatës janë të njëjta me ato që kanë të bëjnë me mungesën e reagimit kur të drejtat në punë shkelen. Frika nga hakmarrja e punëdhënësit dhe papunësia si rrjedhojë për shkak të solidaritetit pengon gazetarët në krijimin e këtij organizimi, por gjithashtu ka edhe një mungesë besimi tek kryesia e sindikatës, nisur nga modelet e dobëta të lëvizjeve dhe organizimeve sindikale në sektorë të tjerë të punësimit në vend. Si rrjedhojë, problematike mbeten pohimet e një pjese të gazetarëve, të cilët deklaruan se do të preferonin të ishin anëtarë joaktivë të saj.

Sipas Barometrit Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri për vitin 2021 të realizuar nga KShH<sup>16</sup>, 194 prej punonjësve të anketuar apo 97% e tyre janë pro ngritjes së sindikatës por megjithatë vetëm 85.5% e tyre shprehën gatishmërinë të ishin pjesë aktive e saj, duke reflektuar një qasje hezituese për shkak të klimës intimiduese prej punëdhënësve të tyre.

Aktualisht, ekzistojnë disa shoqata apo organizata të shoqërisë civile të cilat operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve, por megjithatë ekspertët argumentojnë se këto organizime nuk kanë asnjë të drejtë apo kompetencë në drejtim të garantimit të të drejtave në punë<sup>17</sup>, ashtu siç do të kishte një sindikatë e krijuar sipas ligjit.

Pavarësisht kësaj, në takimet e zhvilluara nga KSHH u vu re një paqartësi që kishin gazetarët mbi rolin e shoqatave të gazetarëve, pasi shumë pjesëmarrës mendonin se ato mund t'i përfaqësonin edhe në procese gjyqësore për të mbrojtur të drejtat e tyre, kjo edhe për shkak se në kuadër të projekteve të ndryshme, disa prej organizatave ofrojnë edhe ndihmë ligjore falas për gazetarët,

---

<sup>16</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi\\_Tetor-2022-KShH.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf)

<sup>17</sup> <https://alert.al/blog/probleme-shumevjecare-ne-pune-sindikata-e-vetmja-rruge-per-punonjesit-e-medias/>

edhe pse kryesisht në nivel individual dhe jo në kuadër të një sindikate Ndërkaq, gazetarët u shprehën njëzëri se krijimi i një sindikate për punonjësit e medias do të ishte një zgjidhje, për të përmirësuar një sërë aspektesh në drejtim të marrëdhënies kontraktuale dhe të drejtave të tyre në punë.

Sipas avokatit Dorian Matlija, i cili ishte pjesë e takimeve nga gazetarët, “sindikata do iu ofronte gazetarëve mbrojtje ligjore, si dhe do i hapte rrugën përmirësimit të kushteve të punës”. Sipas tij *“përfitimi më i madh i një sindikate është kontrata kolektive, ku përfshihen kushtet e punës, lejet e zakonshme, oraret e zgjatura, lejet e lindjes, që janë të përgjithshme për të gjithë. Të gjitha këto mbrohen me kontratë kolektive. Në rast se punëdhënësi nuk do që ta nënshkruajë këtë kontratë, ose e ka nënshkruar por nuk e respekton, sindikata ka instrumentin e grevës, mund të kërkojë inspektime nga Inspektorati i Punës, etj., dhe ndërkohë greva e tyre konsiderohet e ligjshme. Çdo grevë që bëhet aktualisht mund të cilësohet e paligjshme dhe këta punonjës mund të pushohen nga puna duke i dhënë të drejtë punëdhënësit”*<sup>18</sup>.

#### 4. KRAHASIMI ME SITUATËN NË RAJON

Ndërsa në seksionet më sipër evidentohen problematikat kryesore me të cilat ndeshen punonjësit e medias në Shqipëri, vlen të theksohet se shkeljet e të drejtave të gazetarëve, e sidomos problemet me lirinë e medias nuk është vetëm një fenomen i izoluar vetëm në vendin tonë, Problematika të tilla vihen re edhe në vendet e rajonit, ku ndonjëherë situata në Shqipëri reflektohet më neutrale nëse e krahasojmë me situatën në disa vende në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

##### 4.1 LIRIA E MEDIAS DHE TË DREJTAT E GAZETARËVE NË SERBI

Sipas “Reporterëve pa Kufij”, Serbia renditet e 93-a nga 180 vende në lidhje me lirinë e medias. Sipas tyre, në Serbi gazetarët kufizohen, censurohen apo vete censurohen kur bëhet fjalë për të botuar kërkime mbi krimin e organizuar apo tema të ngjashme. Tregu mediatik në Serbi është shumë i përqendruar dhe shteti, si financuesi dhe reklamuesi më i madh i medias, ka një ndikim të rëndësishëm në raportim.<sup>19</sup>

Situata paraqitet kritike edhe në progres raportin e Komisionit Evropian për Serbinë, për vitin 2021. Duket se problematika me e madhe mbetet kërcënimi që u bëhet gazetarëve, sidomos nga

<sup>18</sup><https://alert.al/blog/probleme-shumevjecare-ne-pune-sindikata-e-vetmja-rruge-per-punonjesit-e-medias/>

<sup>19</sup><https://www.reporter-ohne-grenzen.de/serbien/>

zyrtarë të lartë. Intimidimi i gazetarëve paraqitet sidomos shqetësues në nivel lokal. Theksi vazhdon të vihet tek kërcënimi dhe dhunimi i gazetarëve për shkak të ushtrimit të detyrës së tyre. Kështu, rasti i një gazetaresje investigative në Serbi, të cilës ju vu në flake shtëpia, ende mbetet pa asnjë të ndëshkuar.<sup>20</sup>

Në dhjetor 2020, Prokuroria e Përgjithshme në Serbi, kontribuoi në përmirësimin e kushteve dhe të drejtave të gazetarëve në Serbi, pasi nxori një udhëzim të detyrueshëm për të gjithë prokurorët, duke urdhëruar të ndërmerreshin veprime urgjente – me procedurë të përsheptuar – në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Kështu, prokurorët në Serbi janë të detyruar të mbajnë evidenca të veçanta në lidhje me veprat penale të kryera ndaj gazetarëve.<sup>21</sup> Ky është një aspekt pozitiv për situatën e të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias në Serbi, e cila në vështrim krahasues me Shqipërinë, tregon një rritje të ndërgjegjësimit dhe proaktivitetit të institucioneve shtetërore në mbrojtjen e gazetarëve, ndryshe nga institucionet në Shqipëri, ku ka një mungese edhe të kategorizimit të çështjeve gjyqësore të gazetarëve, duke bërë të vështirë kështu edhe analizimin e rasteve të suksesit të ndjekjes së çështjeve në gjykatë.

Nga ana tjetër, sa i përket të drejtave të gazetarëve në punë, sipas progres raportit, mungesa e sigurisë së punës së gazetarëve dhe mjedisi redaktues, që favorizon ‘tabloidizmin’, nuk janë të favorshme për përmirësimin e standardeve të punës së gazetarëve. Kushtet e punës u ndikuan edhe nga pandemia e COVID-19 e cila rezultoi në përkeqësimin e situatës ekonomike të mediave në Serbisë, të cilat u goditën nga një reduktim kritik i të ardhurave nga reklamat që çoi edhe në përkeqësimin e situatës për gazetarët.

#### ***4.2 KUSHTET DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE TË MEDIAS NË MAQEDONINË E VERIUT***

Situata në Maqedoninë e Veriut gjithashtu nuk paraqitet plotësisht pozitive, pasi sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2021 për vendin, sfidat mbeten në zbatimin e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive. Rastet e dhunës fizike dhe verbale si dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias janë shtuar përgjatë vitit raportues. Gjithashtu raporti evidenton se kushtet e punës, veçanërisht të drejtat e punës dhe të drejtat sociale të gazetarëve apo punonjësve në media, mbeten shumë të vështira.

---

<sup>20</sup> <https://balkaninsight.com/2020/04/21/some-balkan-states-waging-crusade-against-media-report-warns/>

<sup>21</sup> [file:///C:/Users/User/Downloads/Serbia-Report-2021%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Serbia-Report-2021%20(1).pdf)

Të dhënat tregojnë se në vitin 2020 në Ministrinë e Brendshme të Maqedonisë së Veriut janë raportuar në total dhjetë raste të kanosjes së gazetarëve për shkak të punës së tyre. Problematike gjithashtu evidentohet se në pesë prej këtyre rasteve, gazetaret të cilët janë fyer dhe/ose kërcënuar kanë qenë vajza dhe gra. Në fillim të vitit 2021, kishte gjithashtu një sulm fizik dhe një kërcënim me vdekje të regjistruar.

Për sa i përket të drejtave të gazetarëve si dhe kushteve në të cilat ata punojnë, veçanërisht të drejtat e tyre të punës dhe sociale, sipas progres raportit ka ende vend për përmirësim të ndjeshëm, veçanërisht në nivel lokal. Sipas një ankete të realizuar nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, u evidentuar se 23% të punonjësve të medias nuk u mbulohen sigurimet shëndetësore dhe sociale, një problematikë e ngjashme me situatën në Shqipëri. Të ardhurat e ulëta, si dhe mosrespektimi i ligjit për marrëdhëniet e punës nga punëdhënësit janë më së shumti sfida të përbashkëta dhe të vazhdueshme për gazetarët. Për shkak të kushteve të këqija të punës, gazetarët dhe punonjësit e medias janë më të ndjeshëm ndaj vetë censurës.<sup>22</sup>

Ndërkohë Reporterët pa kufij rendisin Maqedoninë e Veriut në vendin e 92-ë nga 180 vende në vitin 2021, me një përmirësim nga viti i kaluar, të cilin raporti ia atribuon më së shumti përpjekjeve për vetërregullim më të mirë dhe publikimit të një regjistri të mediave profesionale online. Vetërregullimi i medias është një temë e diskutuar gjerësisht edhe në Shqipëri, megjithatë nuk janë marrë hapa për konkretizimin e saj. Nisur nga eksperiencia e Maqedonisë së Veriut, edhe situata në Shqipëri mund të përfitojë një përmirësim të dukshëm për shkak të vetërregullimit. Gjithashtu, Reporterët pa Kufij venë në dukje se në Maqedoninë e Veriut, autoritetet shtetërore janë ende në gjendje të shfaqin reklama në media të ndryshme, gjë që mbetet një mjet për presion financiar mbi mediat, e për pasojë mbi gazetarët e punonjësit e tyre.<sup>23</sup>

#### **4.3 SITUATA E LIRISË SË SHPREHJES DHE TË DREJTAVE TË GAZETARËVE NË KOSOVË**

Sa i përket lirisë së shprehjes, Kosova karakterizohet nga një mjedis pluralist dhe i gjallë mediatik. Megjithatë, problematikat kryesore lidhen me fushatat e shpifjeve publike, kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve. Media përballet me një sërë sfidash, si mungesa e vetë qëndrueshmërisë financiare, e cila shënoi përkeqësim të mëtejshëm nga pandemia e COVID-19, çka i bëri mediat vulnerabël ndaj interesave politike dhe të biznesit. Për shkak të mungesës së financimit nga palë

---

<sup>22</sup> [file:///C:/Users/User/Downloads/North-Macedonia-Report-2021%20\(3\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/North-Macedonia-Report-2021%20(3).pdf)

<sup>23</sup> <https://balkaninsight.com/2020/04/21/some-balkan-states-waging-crusade-against-media-report-warns/>

të tjera, transmetuesi publik apo televizioni publik në Kosovë mbetet i cenueshëm ndaj ndikimit politik dhe ende duhet gjetur një zgjidhje e qëndrueshme për financimin e tij.<sup>24</sup>

Gjatë vitit 2020 janë regjistruar të paktën dy raste të raportuara kur gazetarët iu nënshtruan gjykimit arbitrar nga institucionet e sigurisë ose të drejtësisë së Republikës së Kosovës, si rezultat i raportimit të tyre publik. Gjithashtu situata e kushteve të punës së gazetarëve paraqitet e ngjashme me situatën në Shqipëri, ku pozita e shumë gazetarëve në mediat private u evidentua si e paqëndrueshme dhe u përkeqësua sidomos për shkak të pandemisë. Pagat e ulëta dhe mosrespektimi i të drejtave të tyre të punës ishin gjithashtu, problemet më të mëdha. Edhe në Kosovë, aksesit në gjykatë nuk është i lehtë pasi gazetarët kanë frikë të padisin për presion ose mosrespektim të të drejtave të punës dhe si të krijojnë sindikata në mediat private.<sup>25</sup>

Ashtu si në Shqipëri edhe në Kosovë, në mungesë të një sindikate të mirëfilltë që i përfaqëson interesat e të gjithë gazetarëve dhe për t'i mbrojtur të drejtat e punës në Kosovë, një organizatë jo qeveritare si AGK-ja (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës) shërben si organi kryesor advokues për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.

Vendi i parë i cili ka arritur të krijojë një sindikatë duke bashkuar kështu punonjësit e medias ishte Serbia në vitin 2002, e pasuar edhe nga Maqedonia e Veriut në vitin 2010 dhe Mali i Zi në vitin 2013.<sup>26</sup> Pavarësisht kohës së gjatë të adoptimit të sindikatave të gazetarëve në rajon, si Shqipëria ashtu edhe Kosova nuk kanë bërë përpjekje në këtë drejtim duke bërë që edhe pas dy dekadash, të drejtat e gazetarëve të mos mbrohen njësoj si të drejtat e punonjësve të medias në Shqipëri.

## **5. LIRIA E MEDIAS DHE TË DREJTAT E GAZETARËVE NË BASHKIMIN EVROPIAN**

### **5.1 LIRIA E MEDIAS NË BASHKIMIN EUROPIAN**

---

<sup>24</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda\\_21\\_5278](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_5278)

<sup>25</sup> [https://agk-ks.org/site/assets/files/2788/jsi\\_shqip.pdf](https://agk-ks.org/site/assets/files/2788/jsi_shqip.pdf)

<sup>26</sup> <https://alert.al/blog/probleme-shumevjecare-ne-pune-sindikata-e-vetmja-rruge-per-punonjesit-e-medias/>



Gazetarët dhe punonjësit e medias në Bashkimin Evropian janë përballur me një numër në rritje sulmesh gjatë viteve të fundit, duke përfshirë edhe atentate në rastet më tragjike. Vetëm në vitin 2020 rreth 900 sulme kundër gazetarëve kanë ndodhur në vendet anëtare të Bashkimit Evropian.<sup>27</sup> Të dhënat tregojnë se kriza e COVID-19 e ka bërë punën e punonjësve në media edhe më të vështirë, me të ardhura më të ulëta, veçanërisht për profesionistët e pavarur, dhe akses të kufizuar në disa ambiente gjatë ushtrimit të punës së tyre.

Në raportin e vitit 2021 mbi sundimin e ligjit në Bashkimin Evropian<sup>28</sup>, Komisioni Evropian ka evidentuar një përkeqësim të situatës së gazetarëve në disa shtete anëtare. Sipas këtij raporti jo të gjithë rregullatorët e medias janë të lirë nga ndikimi politik dhe ekziston një rrezik i lartë i ndërhyrjes politike në media në disa nga vendet anëtare. Pandemia e COVID-19, e cila vazhdoi edhe përgjatë vitit 2021, e vështirësoi punën e gazetarëve, veçanërisht situatën ekonomike të tyre. Pikërisht për këtë arsye shumë vende anëtare iniciuan disa skema ndihmëse edhe për gazetarët, të cilat sipas këtij raporti duhej të ishin implementuar në një mënyrë më transparente dhe të drejtë.

Në kuadër të këtij raporti, Komisioni Evropian ka ndërmarrë një nismë për të matur lirinë e medias si dhe pluralizmin në vendet e Bashkimit Evropian. Monitori i Pluralizmit të Medias 2021 ka vlerësuar risqet që liria dhe pluralizmi i medias ka patur në vendet anëtare përgjatë këtij viti, duke u fokusuar kështu në 4 fusha kryesore si *mbrojtja themelore e lirisë së medias, pluraliteti i tregut, pavarësia nga ndërhyrjet politike, dhe përfshirja sociale*. Rezultatet e fundit të këtij Monitori dëshmojnë për një përkeqësim të situatës në raport me vitin 2020, sidomos në tre fusha kryesore: liria e shprehjes, mbrojtja e së drejtës së informimit, si dhe mbrojtja e gazetarëve.

Problematike vazhdon të mbetet edhe ndikimi që politika ka në media e evidentuar në disa nga vendet anëtare, ku në disa raste pronësia e mediave të caktuara përbën rrezik për pluralitetin e tregut. Nga ana tjetër, nevoja për të garantuar sigurinë e gazetarëve nga sulme dhe kërcënime për shkak të detyrës është rritur, sidomos pas vrasjes së dy gazetarëve grek dhe hollandez në vitin 2021. Rreziku më i madh për ngjarje të tilla raportohet të jetë i lidhur me gazetarët që hetojnë dhe raportojnë mbi çështje të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi masiv i mediave sociale i kanë kthyer këto platforma edhe si mundësi për të sulmuar dhe kërcënuar gazetarët, e cila vërehet si një shqetësim në të gjithë Bashkimin Evropian. Gazetarët vajza dhe gra si dhe gazetarët që i përkasin minoriteteve mbeten më të targetuarit nga këto sulme. Shpeshherë sulmet ndaj gazetarëve iniciohen edhe nga vetë politikanët.

---

<sup>27</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_21\\_4632](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_4632)


<sup>28</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52021DC0700&from=EN>



## 5.2 LIRIA E SHPREHJES DHE TË DREJTAT E GAZETARËVE NË BE NË VËSHTRIM KRAHASIMOR ME SITUATËN NË VENDIN TONË


Siç u përmend më herët, mekanizimi i Bashkimit Evropian për të matur lirinë dhe pluralizmin e medias, është Monitori i Pluralizmit të Medias<sup>29</sup>, i cili veç të dhënave për shtetet anëtare, përfshin edhe të dhëna për shtetet candidate për tu bërë pjese e familjes evropiane si Shqipëri, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Turqi.

Nga të dhënat e këtij Monitori, situata në vendin tonë paraqitet shqetësuese sidomos në aspektin e pavarësisë së medias nga ndikimi politik, ku niveli i riskut paraqitet i lartë, me rreth 79%, në krahasim me një risk mesatar që kanë në përgjithësi vendet anëtare të BE-së që arrin nivelin deri në 57%. Në aspektin e ndikimeve, qoftë nga politika por edhe nga faktorë të tjerë, liria editoriale në vendin tonë gjithashtu paraqet një risk të lartë prej 88% e cila është shumë herë më e lartë se sa ajo e mesatares së vendeve të Bashkimit European e cila mbetet në nivelin e 59% të riskut përse i përket lirisë editoriale.



<sup>29</sup> <https://cmpf.eui.eu/mpm-2021-interactive/>

Lidhur me mbrojtjen e lirisë së shprehjes apo të medias, situata në Bashkimin Evropian, në bazë të të dhënave të këtij Monitori, paraqitet më një rrezik të ulët, më një mesatare prej 34% për vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, të dhënat për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në Shqipëri paraqesin një risk pothuajse dyfish në të madh në krahasim me nivelin mesatar të vendeve të BE-së, duke patur një mesatare prej 60% risk për mbrojtjen e lirisë së medias.



Në bazë të raportit mbi sundimin e ligjit në vende anëtare të Bashkimit Evropian<sup>30</sup>, raportohet si një rrezik i madh në vendet ku lejohet që aktorë politikë të jenë pronarë të platformave të ndryshme mediatike, për shkak të presionit që politika mund të shkaktojë te gazetarët dhe punonjësit e medias. Pavarësisht problematikave me ndikimin jo të drejtpërdrejtë të politikës në media, një shqetësim i tillë sa i takon pronësisë së mediave nga aktorët politikë nuk raportohet për vendin tonë në raporte të ndryshme studimore, përfshirë edhe të dhënat e Raportit të vitit 2021 të Komisionit Evropian për Shqipërinë<sup>31</sup>. Nga ana tjetër sa i përket ndërhyrjeve politike, në vendin tonë paraqitet shqetësuese situata në lidhje me kërcënimet dhe intimidimet që u bëhen gazetarëve nga politikanë. Referuar Barometrit Kombëtar të Lirisë së Shprehjes për vitet 2020 dhe 2021, gazetarët përcjellin si shqetësuese dhunën verbale ndaj tyre prej kryeministrit apo politikanëve të tjerë.

Megjithëse edhe në vende anëtare të BE-së fenomeni i ndikimit dhe ndërhyrjes politike është i pranishëm, në rastin e Shqipërisë ky fenomen paraqitet më flagrant dhe i rrezikshëm ndërkohë që nuk përjashtohet as mundësia e lidhjeve politike që pronarët e medias mund të kenë me politikanë,

<sup>30</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52021DC0700&from=EN>

<sup>31</sup> [file:///C:/Users/User/Downloads/Albania-Report-2021%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Albania-Report-2021%20(1).pdf)

duke ndikuar kështu tërthortazi në lirinë editoriale të gazetarëve nga ndikimet politike. Barometri i lirisë së medias në Shqipëri, realizuar nga KShH për vitin 2021 evidenton rritje të rasteve të kërcënimit fizik dhe verbal ndaj gazetarëve e punonjësve të media. Pavarësisht se ka një rënie të lehtë në raport me një vit më parë, vijon të jetë shqetësues fakti se afro një në dy gazetarë janë censuruar nga struktura hierarkike dhe drejtuese e redaksisë dhe po kaq, prej tyre kanë pësuar vetë-censurë. Ndërkohë, pjesa më e madhe e të anketuarve apo 68% e tyre (2.5% më shumë se vitin e shkuar) perceptojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë. Përfaqësues të politikës në nivel qendror apo vendor mbeten sërish censuruesit dhe kufizuesit kryesorë të lirisë së medias sipas të anketuarve, të ndjekur sërish nga pronarë të medieive, përfaqësues të strukturave shtetërore, kryesisht ato policore dhe persona të identifikuar si të përfshirë apo implikuar në krim.

Siç evidentohet në seksionet e mëparshme, informaliteti në punë vazhdon të mbetet një nga shqetësimet kryesore që gazetarët shqiptarë shprehin në takime të realizuara me përfaqësues të KShH-së, duke shfaqur një mosbesim, se ekziston një vullnet i vërtet politik për të luftuar informalitetin. Shqetësime të tilla në lidhje me informalitetin në punë, duket se nuk janë evidente në vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Raporti i Komisionit Evropian mbi sundimin e ligjit në Bashkimin Evropian, gjatë analizës që i ka bërë situatës së medias dhe lirisë së shprehjes nuk e paraqet si shqetësim in formalitetin. Në këtë drejtim, vendi jonë duhet të bëjë përpjekje reale për përmirësimin e situatës së in formalitetit, jo vetëm të punonjësve të medias, duke marrë në konsideratë aspiratat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Në Shqipëri nuk ka parashikime të veçanta që rregullojnë statusin e gazetarëve. Të drejtat dhe detyrimet në marrëdhënien e punës të gazetarëve, ashtu si për pjesën tjetër të popullsisë, rregullohen nga Kodi i Punës, duke mos patur kështu një përkufizim me ligj të profesionit “gazetar” apo “gazetari”. Nga ana tjetër, në disa vende anëtare të Bashkimit Evropian,<sup>32</sup> si Belgjika, Franca apo Ukraina, ka një përkufizim të parashikuar me ligj të termit “gazetar”. Megjithatë ka vende të tjera si Gjermania dhe Polonia të cilat nuk e kanë një përkufizim të tillë e si rrjedhojë nuk e kanë të rregulluar statusin e profesionit të gazetarit, duke mos patur nevojë për t’ju nënshtruar procedurave formale. Gazetarët në vendin tonë e paraqesin si problematike mungesën e këtij përkufizimi, pasi e konsiderojnë shumë të rëndësishëm dhe si një mënyrë për të rregulluar profesionin e gazetarit.

Sa i takon kushteve në të cilat gazetarët dhe punonjësit e medias punojnë, siç evidentohet edhe në të dhënat e Barometrit Kombëtar për Lirinë e Medias për vitin 2020 të realizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gazetarët e anketuar dëshmojnë për një nivel të lartë stresi dhe tronditjeje psikologjike të shkaktuar për shkak të punës së tyre. Një situatë e ngjashme në fakt paraqitet edhe në vende anëtare të Bashkimit Evropian. Një raport i Komitetit për Kulturën, Shkencën, Edukimin

---

<sup>32</sup> <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=24287&lang=en>

dhe Medias pranë Parlamentit Evropian<sup>33</sup> tregon për një rritje të nivelit të stresit dhe jo produktivitetit të gazetarëve për shkak të mbi ngarkesës në punë, pasigurive për vendin e punës për shkak të rritjes së konkurrencës etj. Duket se një problematikë e tillë është e lidhur ngushtësisht me profesionin dhe jo me vendin e ushtrimit të tij, pasi evidentohen ngjashmëri të këtij fenomeni si në Shqipëri, në rajonin e Ballkanit Perëndimor ashtu edhe në Bashkimin European.

Lidhur me organizimin në sindikata, në raportin për sundimin e ligjit të Bashkimit Evropian, evidentohet se në shtetet anëtarë të BE-së ekzistojnë sindikata të posaçme për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të medias. Kështu, në Gjermani, Francë, Poloni, Austri, Danimarkë, Belgjikë, Itali dhe Hollandë, gazetarët janë të organizuar brenda tyre në sindikata për profesionin e gazetarëve. Megjithatë, vihet re një mungesë uniformiteti në nivel qendror evropian, duke bërë që secili shtet anëtar të ketë kritere të veçanta për gazetarët të cilët mund të bëhen pjesë e këtyre sindikatave. Për shembull, në Francë dhe Belgjikë, pjesë e këtyre sindikatave mund të jenë vetëm gazetarët e akredituar, ndërkohë që në Gjermani pjesë e këtyre sindikatave mund të jenë edhe studentë gazetarie, gazetarë të dalë në pension, kategori të tjera si: prezantues, blogger etj. Gjermania duket se ka një model liberal të konceptit të profesionit të gazetarit, i cili është më gjithëpërfshirës dhe ndaj nuk ka parashikime të veçanta që të rregullojnë statusin e akreditimit të tyre. Ndërkohë që në vendet anëtare të BE-së ngrihet si çështje problemi i plakjes së anëtarëve të këtyre sindikatave si dhe përfshirjes apo jo të gazetarëve që operojnë të lirë (apo siç njihet ndryshe si “freelancer”) apo me kohë të pjesshme në këto sindikata, në vendin tonë, në ndryshim edhe nga vendet e rajonit një sindikatë që përfaqëson gazetarët dhe punonjësit e medias në mbrojtjen e të drejtave të tyre nuk ekziston. Kjo për arsyet e përmendura më sipër.

## 6. RASTE SUKSESI – RIFITIMI I TË DREJTËS SË GAZETARËVE

Prej afro 4 vitesh, KShH në sajë të programit të Klinikës Ligjore Falas të mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike dhe East West Management Institute, ka ofruar me anë të stafit të kualifikuar ligjor të KShH-së, ndihmë juridike dhe përfaqësim gjyqësor falas për gazetarët dhe punonjësit e medias. Mungesa e besimit për t’ju drejtuar organeve gjyqësore vihet re edhe gjatë veprimtarisë së KShH-së. Pavarësisht se gazetarët janë të interesuar të njohin të drejtat e tyre në rast të ndonjë shkeljeje nga punëdhënësi, ata hezitojnë ta ndjekin çështjen në rrugë gjyqësore ose për arsye të ndryshme tërhiqen nga procesi në faza të ndryshme para fillimit të procesit gjyqësor.

Nga korrespondenca që ka patur me gjykatat, KShH ka vërejtur se mungon një sistem i unifikuar i mbledhjes dhe përpunimit të dhënave për çështjet gjyqësore me palë gazetarët apo punonjësit e medias, të cilët mund të jenë në statuse të ndryshme procedurale si të akuzuar, viktimë, të dëmtuar, paditës apo të paditur. Për shkak të mënyrës së grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, nuk

---

<sup>33</sup> <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=24287&lang=en>

mund kryhet një cilësim i profesionit të palës dhe për pasojë nuk e kanë të mundur të evidentojnë çështjet me palë gazetarë apo punonjës të medias. Mungesa e statistikave të besueshme dhe të sakta bën të pamundur vlerësimin e drejtë të numrit të çështjeve ku gazetarët kërkojnë të drejtat e tyre ose vuajnë pasojat e ushtrimit të profesionit për shkak se janë paditur apo marrë të pandehur.

Keti Banushi<sup>34</sup> është një gazetare e cila e nisi punën në media 23 vjet më parë. Gjatë karrierës së saj, ajo ka mbuluar kryesisht çështjet e kronikës së zezë dhe drejtësisë në disa media të rëndësishme në vend. Por, përpos karrierës së gjatë, rreth 4 vjet më parë, ajo u përball me një situatë të pazakontë në vendin e punës. *“Punoja në atë televizion prej 6 vitesh, por një moment Drejtori i Informacionit debatoi me mua dhe më tha ‘ik në shtëpi’. Shkova te Drejtori i Përgjithshëm, por ai më komunikoi që ‘përsa kohë Drejtori i Informacionit nuk dëshiron të bashkëpunojë me ty, unë nuk kam çfarë të bëj’. Ishte e dhimbshme të kuptoja se vetëm për një kundërshtim që mund të kesh me drejtorin, hidhesh në rrugë. Por, kur je profesionistë edhe do të kundërshtosh”,* - kujton gazetarja.

Në këto kushte, gazetarja kërkoi nga drejtuesit që vendimi për largimin e nga puna t’i jepej me shkrim, por kjo kërkesë u refuzua prej punëdhënësit. Duke patur eksperiencë me mbulimin e çështjeve të drejtësisë, Keti me ndihmën e një avokati kërkoi menjëherë ndihmë juridike për të vënë në lëvizje gjykatën me anë të një kërkesë padie.

Megjithatë, vendimi i gazetares për të ndjekur çështjen e saj në rrugë gjyqësore nuk kaloi pa pengesa. *“Në momentin që televizioni u njoftua se unë kisha bërë padi, në një kohë që kishte kaluar 1 muaj nga largimi im, më sjellin disa dokumente, ku më kërkonin të kthehesha në punë e ku pretendohej se isha unë që kisha braktisur detyrën”,* - tregon gazetarja. Ky mekanizëm ishte një tentativë e punëdhënësit për të treguar se nuk e kishin larguar nga puna por gazetarja kishte ikur vetë. Megjithatë, depozitimi i kërkesë padisë në kohë, ishte një garanci për të drejtën e shkelur për shkak të datës së mëparshme në krahasim me njoftimet e punëdhënësit.

Keti kujton edhe vështirësitë, me të cilat u përball, por dëshira për vendosur drejtësi e bëri të ndiqte çështjen e saj në rrugë gjyqësore. *“Sigurisht që ishte e vështirë, pasi isha përballë një televizioni të fuqishëm e ku gazetari është inferior”,* - shprehet gazetarja. *“Gjithashtu, pjesa financiare ishte shumë problem sepse isha në kushtet që isha e vetme, me 2 fëmijë dhe me 1 rrogë, por u detyrova që të ndiqja çështjen në rrugë gjyqësore”,* - shton ajo.

Përballja në gjykatë nuk ishte e lehtë, por pas një procesi gjyqësor që në shkallën e parë u fitua nga televizioni i paditur, në Gjykatën Administrative të Apelit gjithçka shkoi në favor të gazetares.

---

<sup>34</sup> Përdorimi i emrit të gazetares nga KShH është realizuar me miratimin paraprak të saj.

*“Faktet janë kokëforta. Gjykata njohu të drejtën që ishte bërë shkelje, pasi u vërtetua që largimi ishte bërë pa paralajmërim, pa ndjekur parashikimet e Kodit të Punës dhe detyroi punëdhënësin të më dëmshpërblente me 11 paga”, - thotë Ketë. “Dihet që avokatët e një televizioni të madh janë më të fortë, por ishte këmbëngulja ime që më çoi drejt fitores. Unë mendoj që është rast suksesi sepse unë reagova që në momentin e parë, ndërkohë që shumë punonjës të tjerë të medias vonohen, pasi mendojnë se mund t’i zgjidhin problemet në forma të tjera”, - shton më tej gazetarja.*

Gjithashtu, përpos faktit se shumë gazetarë i druhen paditjes së punëdhënësve të tyre, me frikën se do të hasin probleme me punësimin nga punëdhënësi të tjerë, për Ketin nuk ishte aspak kështu. *“Normalisht, sa u mor vesh që unë isha larguar nga ai televizion, pata menjëherë oferta nga televizione të tjerë dhe fillova direkt punë”, -thotë gazetarja. “Ndaj inkurajoj të gjithë ata punonjës të mediave, që hasin në probleme të ngjashme, të ndjekin rrugën që zgjedha unë”, -përfundon ajo.*

## **7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Problematikat e referuara nga gazetarët gjatë takimeve me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, janë problematika sistemike të cilat janë të mbartura prej një kohe të gjatë në vendin tonë. Ndërkohë që një pjesë e këtyre problemeve janë të lidhura ngushtësisht me profesionin e gazetarit, si censura apo ndikimet politike, një pjesë tjetër e shqetësimeve, si informaliteti në punë reflekton gjithashtu një situatë të përgjithshme pa dallim profesioni në Shqipëri. Nga ana tjetër, mosrespektimi dhe shkelja e të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias, ashtu si edhe situata e lirisë së medias, rezulton se nuk është vetëm një problem kombëtar. Situata në rajonin e Ballkanit Perëndimor paraqitet shumë e ngjashme më situatën në vendin tonë duke reflektuar kështu edhe problematika të cilat ndeshen më rrallë në vendin tonë, siç mund të jenë raste të shumta të kërcënimit dhe intimidimit të gazetarëve. Megjithatë krijimi i sindikatave të gazetarëve dhe punonjësve të medias në vendet fqinje është një arritje drejt një respektimi më të madh të të drejtave të gazetarëve, e cila duhet të përqafohet sa më shpejt si praktikë edhe në vendin tonë. Praktika të mira gjenden edhe në Bashkimin Evropian ku ndërkohë që problemet me informalitetin në punë nuk janë të pranishme, ka një rregullim më të posaçëm të legjislacionit në lidhje me profesionin e gazetarit në disa nga vendet anëtare.

Çdo mangësi në fushën e lirisë së medias dhe pluralizmit të medias në Shqipëri rrezikon nivelin e përgjithshëm të standardeve demokratike të cilat vendi jonë synon të arrijë. Problematikat e gazetarëve dhe punonjësve të medias përfshijnë aspekte të ndryshme ligjore, politike dhe ekonomike, dhe puna për përmirësimin e të drejtave të tyre duhet të fokusohet në të gjitha këto aspekte. Nga analiza vihet re se situata nuk ka patur përmirësim nga vitet e mëparshme, për sa i përket respektimit të të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias, duke reflektuar kështu një mbartje të problematikave të tyre ndër vite.

Nisur nga problematikat e evidentuara, KShH ka hartuar një sërë rekomandimesh drejtuar aktorëve të ndryshme me qëllim përmirësimin e situatës të të drejtave të punonjësve të medias në Shqipëri:

## **7.1 REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET PUBLIKE**

- KShH sugjeron që Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), të zbatojë kompetencat e parashikuara në ligj, duke kryer monitorime objektive dhe të paanshme në redaksitë e mediave audiovizive dhe të shkruara, si dhe të marrë masa të menjëhershme në rastet e konstatuara në shkelje<sup>35</sup>. Rekomandohet që realizimi i monitorimeve, gjetjet e tyre apo masat administrative të vendosura ndaj punëdhënësve në sektorin e medias të jenë sa më publike, si dhe të gjendet hapësira edhe brenda medias për promovimin e tyre me qëllim ndërgjegjësimin si të punëmarrësve ashtu edhe të punëdhënësve.
- KShH rekomandon kryerjen e verifikimeve në terren, nga administrata tatimore, sipas përcaktimeve ligjore, lidhur me regjistrimin formal të punonjësve<sup>36</sup> në media. Sikurse përcaktohet edhe në ligj, këto verifikime duhet të kryhen pa njoftimin paraprak të personit të tatueshëm, ndërsa për kundërvajtjet administrative tatimore, të evidentuara gjatë verifikimit në terren duhet të merren masat administrative. Sikurse, në rastin e kontroleve nga ISHPSHSH rekomandohet që këto verifikime dhe konstatimet e kryera të bëhen publike me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e llogaridhënies së aktorëve të përfshirë.
- KShH rekomandon rritjen e bashkëpunimit ndërinstucional për adresimin e problematikave të evidentuar, me anë të kryerjes së monitorimeve/verifikimeve të përbashkëta mes administratës tatimore dhe ISHPSHSH-së, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, që kërkojnë përpjekje konkrete nga ana e inspektorateve (si Inspektorati i Punës (ISHPSHSH) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe agjencive të ngritura me synim monitorimin objektiv, të paanshëm dhe joselektiv si dhe në mënyrë rigorozë të zbatimit të kuadrit ligjor nga ana e entiteteve private dhe atyre publike<sup>37</sup>.
- KShH sugjeron që gjithashtu Kuvendi i Shqipërisë të luajë një rol proaktiv në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve në vendin e punës dhe veçanërisht, Komisioni parlamentar për Median dhe Mjetet e Informimit Publik, i cili ka në fushën e përgjegjësisë mediane e shkruar dhe atë vizive. Rekomandohet zbatimi i kompetencave të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit<sup>38</sup>, duke kryer seanca dëgjimore me drejtuesit e institucioneve kontrolluese përgjegjëse të sipërcituara, apo çdo institucion tjetër që mund të ndikojë pozitivisht në respektimin e të drejtave në punë të gazetarëve. Gjithashtu, rekomandohet që, Komisioni të organizojë seanca dëgjimore publike me ekspertë, përfaqësues të

---

<sup>35</sup> Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

<sup>36</sup> Neni 81/1, Ligji Ligj Nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

<sup>37</sup> Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

<sup>38</sup> Vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, ”Rregulorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

shoqërisë civile apo përfaqësues të grupeve të interesit për adresimin e problematikave të evidentuar ndër vite të gazetarëve dhe punonjësve të medias. .

## **7.2 REKOMANDIME PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE**

KShH rekomandon për organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë ndihmë ligjore falas ti promovojnë gjerësisht pasi ato nuk njihen gjithmonë nga punonjësit e medias, ndaj rekomandohen fushata promovuese më të fuqishme, në mënyrë që informacioni të arrijë në sa më shumë punonjës të këtij sektori.

- Në mungesë të një sindikate, KShH sugjeron se organizimi i trajnimeve që mundësojnë rritjen e njohurive mbi të drejtat e gazetarëve në vendin e punës, si dhe nxitja për të reaguar në rast të shkeljes së këtyre të drejtave është mjaft i rëndësishëm. Këto trajnime janë të domosdoshme, pasi në shumë raste gazetarët apo punonjësit e medias kanë një mungesë informacioni, në drejtim të të drejtave që iu njeh legjislacioni në fuqi e për pasojë nuk e shikojnë si alternativë rrugën gjyqësore. Organizatat e shoqërisë civile mund të ndikojnë pozitivisht në rritjen e informimit në këtë drejtim.
- KShH rekomandon gjithashtu se është e rëndësishme ndërmarrja dhe konkretizimi i një nisme serioze dhe të qëndrueshme, të organizimit sindikal të punonjësve të këtij sektori, si një kërkesë që vjen drejtpërdrejt nga sektori i medias. Ndërmarrja e kësaj nisme nga organizatat e shoqërisë civile do të lehtësonte procesin dhe do të zbuste barrierat ekzistuese, ndërsa do të garantonte një terren më të favorshëm pune, si dhe mbrojtje të shtuar ndaj praktikave abuzive.

## **7.3 REKOMANDIME PËR GAZETARËT**

- KShH inkurajon gazetarët të rrisin nivelin e pro aktivizimit, të mos heshtin, të mos pajtohen me shkeljet, të kërkojnë rivendosjen e të drejtave të tyre të cenuara. Thënë kjo, KShH do të solidarizohet dhe ofrojë mbështetje ligjore ndaj çdo gazetari që është cenuar në shkelje të ligjit, në të drejtat e liritë e tij për shkak të profesionit apo gjatë ushtrimit të tij.
- KShH rekomandon për të gjithë gazetarët dhe punonjësit e medias që të angazhohen në një sindikatë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Forca e një sindikate qëndron në numrin e anëtarëve të saj. Për këtë arsye është e rëndësishme, që në rast të nismave që synojnë ngritjen e një sindikate për punonjësit e medias, ata të bëhen pjesë e saj. Anëtarësia në një sindikatë nuk nënkupton domosdoshmërisht një pjesëmarrje aktive dhe publike, ndërkohë që legjislacioni shqiptar garanton angazhimin e punonjësve në sindikata.<sup>39</sup>

---

<sup>39</sup> Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar